



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VIII**

***Sesioni vjeshtor***

**Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim**

Mbledhja nr. 68

Prishtinë, më 26.9.2023, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ganimete Musliu, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Samra Ilijazi, Jetmira Vrenezi dhe Isak Shabani.

Munguan: Besian Mustafa dhe Albena Reshitaj.

Pjesëmarrës nga MBPZhR: Ministri Faton Peci, Venera Çerkini-zv.sekretare e përgjithshme, Bekim Hoxha- AUV, Fidan Dema-APK. dhe Flutur Mustafa-kabineti i Ministrit

Pjesëmarrës të tjerë: Ilirjana Hoti nga BIRN, Fjollë Haziri dhe Rozafë Berisha- KDI, Fatbardhë Kërçeli- D+, nga mediat –RTK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Komisioni në fillim mbajti një minutë heshtje për rreshterin e policisë Afrim Bunjaku.

*Në këtë mbledhje u propozua ky*

*Rend i ditës:*

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25.7.2023;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-211 për verëra;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08-L-252 për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga MBPZhR dhe (GIZ) GMBH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve;
5. Raportimi i Ministrit të MBPZhR-së, për çështjet që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë e kësaj ministrie;
6. Te ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi rendin e ditës.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25.7.2023**

*Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 25.7.2023.*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-211 për verëra;**

*Kryetarja, tha se Raportin plotësues me amendamente për këtë projektligj komisioni e ka proceduar te komisionet e përhershme me date 27.7.2023. Komisioni për legjislacion dhe ai për integritet evropian kanë rekomanduar se mund t'i procedohen Kuvendit për miratim, ndërsa Komisioni për Buxhet dhe ai për komunitete nuk ka dhënë rekomandim.*

*Meqë nuk kishte vërejtje, ftoi për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:*

### *Përfundim*

*Komisioni vendosi që Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 08/L-211 për verëra, procedohet në seancë plenare për lexim të dytë*

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08-L-252 për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga MBPZhR dhe (GIZ) GMBH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve.**

*Kryetarja, e paraqiti për shqyrtim dhe tha se ky Projektligj ka për qëllim që të ratifikojë Marrëveshjen në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Für Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale Përmes Diversifikimit të Aktiviteteve. Qëllimi kryesor i projektit të mbështetur nga fondi është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik rural përmes diversifikimit të aktiviteteve në zonat rurale me qëllim të zgjerimit dhe përsheptimit të mundësive të punësimit dhe qëndrueshmërisë së fermave në zonat më pak të favorshme në Kosovë. Kjo marrëveshje Ndërkombëtare është në kuadër të projektit “Promovimi i Ndërmarrësisë”, e cila kontribuon në forcimin e lidhjeve ekonomike me tregun e përbashkët të BE-së dhe e cila mbështetë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rritjen e konkurrencës së tyre dhe gradualisht ndihmon në krijimin e një mjedisi më të mirë biznesi. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit dhe pyeti nëse ka dikush të diskutoj për këtë.*

*Isak Shabani, pyeti a është parapa buxhet për realizimin e kësaj marrëveshje nga Qeveria e Kosovës.*

*Kryetarja tha se në projektligj është i bashkëngjitur deklarata e Ministrisë së financave rreth buxhetit dhe marrëveshja tregon se cilat janë obligimet e Qeverisë dhe të Organizatës.*

*Meqë nuk kishte diskutime tjera, kryetarja ftoi për votim dhe konstatoi se me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### *Rekomandim*

*Të miratohet Projektligji nr. 08-L-252 për Ratifikimin e Marrëveshjes në mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga MBPZhR dhe (GIZ) GMBH, për Projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Sektorit të Bujqësisë në Zonat Rurale përmes Diversifikimit të Aktiviteteve.*

## **5. Raportimi i Ministrit të MBPZhR-së, për çështjet që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë e kësaj ministrie;**

*Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit, e falënderoi Ministrin Faton Peci për përgjigjen për raportim në komision dhe tha se nga vizitat që i ka bërë komisioni në terren, nuk ka ankesa ndaj punës së kësaj Ministrie dhe pastaj ia kalon fjalën Ministrit Faton Peci për te prezantuar raportin e punës së Ministrisë.*

*Ministri i MBPZhR-së, Faton Peci, pasi e prezantoi stafin e tij të pranishëm në mbledhje, tha se Ministria që udhëheq gjithmonë ju ka përgjigjur pozitivisht thirrjes së Komisionit për raportim. Më tej tha se punët kanë avancuar dhe ai e quan këtë vit si “viti më i suksesshëm i sektorit të bujqësisë që nga paslufta” duke prezantuar punët që i ka bërë Ministria: implementimin e suksesshëm të dy planeve si “Programin për pagesa direkte apo subvencione” dhe “Programin për zhvillim rural apo grante”, me pas për herë të parë në vitin 2022 është arritur që brenda vitit fiskal të ekzekutohen të gjitha pagesat në kategorinë e granteve dhe subvencioneve, ku në vitin 2022 përfitues të granteve dhe subvencioneve kanë qenë 32,728 fermer dhe janë ndarë 59,575,000 euro ku pjesa më e madhe ka shkuar në subvencione dhe se kjo është si rezultat i punës së ministrisë dhe rritjes së sipërfaqes bujqësore. Viti 2023 si viti më i suksesshëm e demonstron dhe me shifra, ai merr shembull drithërat ku në vitin 2021 kanë qenë 68,000 hektar të mbjella me drithëra, në vitin 2022 kjo sipërfaqe është rritur në 92,000 hektarë, kurse në 2023 është rritur në 112,206 hektar, është rritur sipërfaqja e mbjellë me drithëra për 62% dhe se është rekord, Ka rritje edhe në kultura tjera si perimet në serra dhe merr shembull Komunën e Mamushës dhe se kjo komunë është përfituese e 4,200,000 euro apo 20 hektar sipërfaqe serrë.*

*Eksporti dhe importi ka bilancin me pozitiv dhe se vjen si rezultat i granteve. Viti 2022 është për herë të parë në rënie prej -3% të prodhimeve bujqësore ndërsa për produktet e perimeve kemi shënuar rritje për 49 %. Ministri tha se para se të vie në krye të ministrisë vlera më e ulët e përkrahjes financiare ka qenë për perimet, ku ndarja për subvencione është bërë në mënyrë të pa-drejtë dhe se ai tashmë e ka ndryshuar këtë fakt.*

*Janë aprovuar një numër i dokumenteve dhe strategjive, si Strategjia e parë në sektorin e bujqësisë, po ashtu është aprovuar plani i veprimit 2022-2024, Ligji i ri për bujqësi, programin kombëtar për bujqësi 2023-2027 dhe programin për grante vjetor 2023. Po ashtu dhe në sektorin e pylltarisë është aprovuar strategjia për zhvillimin e pylltarisë 2022-2030, plani për veprimin e strategjisë për pyjet e Kosovës 2022-2024, krijimin e task-forces për ndalimin e prerjeve ilegale dhe është përgatitë strategjia për aspektin e komunikimit dhe aprovimin e Ligjit të ri për Pyje. Duhet aprovuar 41 udhëzime administrative dhe disa janë në fazën finale, dhe janë në proces të harmonizimit me komuna.*

*Për çështjen dhe problemet që ndërlidhen me pronat, janë marr disa veprime si lirimi i pronave shtetërore të uzurpuara në Stankaj të Pejës në vendin Jashanice, lirimi i pronës në pjesën qendrore të zyrave të Institutit Bujqësor të Kosovës në Ulpiane dhe se Komuna e Prishtinës nuk jep detaje rreth historikut të bartjes së pronave dhe se janë jo bashkëpunues. Në rrugën Prishtine-Fushe Kosove janë adresuar disa prona në prokurori dhe se në mes Prishtinës dhe Fushe Kosovës tek ura e Autostradës janë adresuar 1 hektar e 30 ari, dhe një proces tjetër 10 hektarë në Vitomirice të Pejës ku është parandaluar tjetërsimi i pronës.*

*Në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës janë marr disa veprime si p.sh. aktualizimi i nevojës për parandalimin e pirjes së duhanit në hapësira publike dhe se janë realizuar mbi 500 gjopa mandatore në vlerë 200,000 euro dhe janë mbi 3200 inspektime të realizuara. Janë në proces të bartjes së përgjegjësive të inspektoreve sanitar në Ministrinë e shëndetësisë pasi që kështu e parasheh Ligji për inspektoratin dhe Ligji për ushqimin, janë marr disa veprime për eliminimin e ekonomisë informale.*

*Kryetarja, tha se ende nuk kemi hasur ndonjë fermer që është ankuar në mënyrën e realizimit të granteve apo subvencioneve. Pastaj shtoi se për shkak të reshjeve të shumta këtë vit në perim-*

kulture janë ankuar fermerët pasi që shiu ka ndikuar në produktet e tyre dhe pyet se si mundemi te përgatitemi për ndryshime klimatike dhe se a është duke marr Ministria hapa ne këtë veprim ?

*Salih Zyba*, kërkoi diskutim me specifik rreth asaj që tha ministri “*vitit më të suksesshëm*”, pastaj për shqetësimet buxhetore dhe krahason një prej investimeve te subvencioneve për pagesa direkte, tek shfrytëzimi i parasë publike që ka shkuar përmes bujqve. Për shkak të kushteve klimatike bujqit nuk janë të kënaqur me rendimentin përfundimtar, rritjen e sheh pozitive por kritikon që s’ka ende cilësi dhe se nuk mundemi të krenohemi vetëm me rritje të sipërfaqes, një rezultat duhet të jep dhe produkti final dhe pyet se a ka ndonjë vonese sa i përket pagesave këtë vit? Ai tha se ende mbetet shqetësim vazhdimi i tjetërsimit të sipërfaqes bujqësore, dhe pyeti “ne çfarë mase merrni përgjegjësi tek tokat bujqësore si ndryshim dhe tjetërsim dhe pyet për bashkëpunimin me komunat.

*Ministri Faton Peci*, tha se nuk mundet të bëj asgjë vetëm se të rrite nivelin e përkrahjes për të gjitha kulturat dhe se ai nuk mund ti kontroll reshjet por mund të kontrolloj rritjen e sipërfaqes bujqësore, ai shpreh se Ministria ju mundëson fermerëve të përfitojnë, nëse fermerët kujdesen që rendimenti të jete sa më i lart deri në 8 ton ai do ta merr kompensimin dhe përmendë 54 euro për mbulimin e akcizës se naftës për secilin hektar dhe 120 euro për 4 ton për hektarë por nëse rendimenti është me i cilësuar atëherë fermeri do të merr më shumë.

Është në procedurë një projekt për vlerësimin e cilësisë së tokës, kurse për pyetjen e dëmeve tha se Ministria ka mbuluar dhe kompenzuar 82% te sasisë së demit në një vlerë prej 2.8 milion euro dhe se do të kompenzohen disa dëme që nuk janë realizuar në vitin 2022 për shkak të pa përgjegjësisë së komunave dhe përmend Rahovecin.

Ndërsa në pyetjen për ulje në rendiment në sektorin e vreshtarisë, tha se kjo vje si rezultat i kushteve klimatike, ndërsa Ministria i bashkëngjitet të gjitha iniciativave Evropiane për çështjen e klimës. Ministri përmend partneritetin me organizata ndërkombëtare ku është aprovuar nje marrëveshje me vlerë 9.2 milion euro dhe është nënshkruar dhe një marrëveshje me GIZ-in gjerman në vlerë prej 20,025,000 euro për periudhën 2024-2027 për përkrahjen e fermerëve në zonat e prekura me çrregullimet e tregjeve. Ministri tha se, ne kemi implementuar meritokraci me veprimet tona dhe se viti 2023 është vit rekord për kontroll në terren. Për mbrojtjen e tokave bujqësore, tha se ne kemi krijuar task-forcen për mbrojtjen e tokave bujqësore.

*Kryetarja*, kërkon të përgatiten fermerët në rast të reshjeve të shumta. Po ashtu tha se Ministria duhet të identifikojnë zonat ku do të kenë probleme me ndryshimet klimatike pasi që do të ndihmoj fermerët e prekur nga ndryshimet klimatike.

*Salih Zyba*, interesohet rreth pagesave direkte, ai po ashtu kritikon raportin e punës nga Ministria, specifikisht rreth mungesës së informatave nga komunat specifike rreth pagesave direkte. Ndërsa rreth mashtimeve në vitet e kaluara rreth pagesave dhe pyeti sa do të ndodhin përsëri.

*Ekrem Mustafa*, për pagesat direkte por edhe të granteve, pyeti se sa ka arrit Ministria të implementoj këto pagesa.

*Ministri Faton Peci*, tha se ka 24 milion euro në programin e implementimit të granteve dhe se 18 milion nga 24 milion janë në proces të ekzekutimit, kurse sa i përket programit 2023, janë realizuar rreth 70% të pagesave dhe se 30% janë në proces të implementimit. Për sektorin e blegtorisë janë ndarë 5 milion euro. Ka disa ankesa rreth drejtorëve në ministrinë përkatëse dhe se kanë vendosur kritere diskriminuese në vitet e kaluara por tani ato nuk vlejné. Në vitin 2025 Kosova do të ketë +20 milionë litra qumësht më shumë në sektorin e blegtorisë, kurse tek tema e Matrikules, ai tha se është interesuar sepse ajo ka qenë baza e problemeve të manipulimeve gjatë viteve të mëhershme dhe vazhdon me masat që janë ndërmarr nga Ministria për luftimin e këtyre manipulimeve.

*Ekrem Mustafa*, pyet se a ka ankesa nga fermerët rreth pamundësisë për aplikimi.

*Salih Zyba*, pyeti rreth Ligjit për Pyjet i cili ka hy në fuqi dhe kërkoi një shpjegim rreth procesit të tranzicionit.

*Ministri Faton Peci*, shpjegon mekanizmat e ankesave dhe çdo fermeri që ju ka padrejtë mos të hezitohet të ankohen. Pastaj për ndodhitë në të kaluarën por se tani nuk ka humbje të rasteve në gjykatë por përkundrazi ka dhe raste të fituara ndaj fermerëve. Kurse sa i përket Ligjit të Pyjeve tha se 266 zyrtar do të barten brenda Agjencisë së pyjeve për të menaxhuar dhe parandaluar prerjet ilegale dhe deri në fund të vitit do të ndodh i gjithë procesit i bartjes dhe shpjegon partneritetin me komunat për parandalimin e prerjeve ilegale.

*Ganimete Musliu*, së pari shprehu ngushëllime familjes së dëshmorit Afrim Bunjaku, pastaj tha se ka kritika rreth raportit të punës së Ministrisë dhe se këtë raport e cilëson si një prezantim dhe jo raport, në raport janë 20 ligjet që janë miratuar vitin e kaluar. Pastaj kritika vazhdon dhe me strategjinë për zhvillim e bujqësisë dhe për zhvillimin e pylltarisë, nuk sheh ndonjë zhvillim në sektorët përkatëse dhe se Ministria po krenohet me veprimet që nuk janë rezultatit i Ministrisë, po ashtu se raporti nuk është konform kriterëve të krijimit të raporteve. Pyeti rreth akreditimit të AZHB-së dhe e shpreh shqetësimin rreth drejtorëve në Ministri duke i konsideruar në presion nga Ministri.

*Milazim Salijaj*, paraqiti një ankesë të një fermeri nga Komuna e Gjilanit, fermerit në fjalë ju kane asgjësuar 11 krerë gjedhe. Asgjësimi ka ndodh me 3 vendime dhe se nuk ka pranuar asnjë pagës rreth kompensimit pas asgjësimit. Vazhdon me pyetje për regjistrin e pronave të uzurpuara ne Komunën e Pejës tek Instituti bujqësor dhe se deri ku kanë mbërritur hulumtimet e Ministrisë rreth pronave të këtij instituti dhe a posedon certifikatë. Për kanalet e ujitjes dhe për mundësitë që fermerët pa qasje tek kanalet të mbështeten. Po ashtu pyeti rreth fermerëve ne Komunën e Kaçanikut, pasi që disa fermerë nuk posedojnë qasje ne infrastrukture rrugore.

*Ministri Faton Peci*, përgjigjet kritikave të deputetes Musliu rreth formës dhe përpilimit të Raportit të Punës dhe se për kundër kritikave, udhëzimet administrative dhe strategjitë janë tejet të rëndësishme për punët që i zhvillon ministria, po ashtu Ministri mohon presionin e përmendur për drejtorët dhe shtoi se drejtorët ne Ministri janë të pa përgjegjshëm.

Sa i përket akreditimit, është aprovuar rregullorja e re e AZHB-së dhe se 3 milion euro është vlera monetare e projektit që zbatohet nga GIZ-i Gjerman, po ashtu vazhdon të flas për njërin nga kriteret e AZHB-së për licencë është se Ministria duhet të ketë objekt e saj dhe jo me qira, dhe se shume shpejt fillon hapja e tenderit për objektin dhe për ndërtimin e objektit të Ministrisë së Bujqësisë.

Për pronat e IBK-së, tha se Ministria i ka të gjitha certifikatat e pronësisë dhe fletat poseduese. Ministria ka identifikuar dhe kanë bërë të gjitha matjet për të verifikuar pronat në secilën komunë dhe merr shembull Prishtinën. Sa i përket fermerit nga Komuna e Gjilanit, tha se sot i janë ekzekutuar pagesat. Ministri vazhdon me shembuj të mashtimeve sa i përket kompensimeve dhe përfundimisht pjesa e kompensimit të largohet nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës për shkak të përpilimit dhe aprovimit të rregullores së re dhe dha shembuj nga e kaluara për të shpjeguar pse duhet të largohet nga Agjencia në fjale. Për pyetjen e gjeodeteve, Ministri u shpreh se uzurpatorët duhet të largohen dhe të lirohen të gjitha pronat e Ministrisë së Bujqësisë, por se gjykatat nuk kanë vepruar me kohë.

*Ganimete Musliu*, tha se ministria nuk e ka përpiluar në formë korrekte raportin e punës dhe se Ministri nuk shpreh keqardhje për shëndetin e zyrtareve publik të Ministrisë. Pastaj pyeti për emërimin e sekretarit të përgjithshëm të ministrisë siç tha “tezaken e Vjosa Osmanit” pasi që ajo nga AZHB-së është emëruar në ushtruese e detyrës së Sekretares në Ministri dhe konkretisht pyet se pse ka ndodhe kjo lëvizje dhe pse është bërë kjo zhvendosje duke e ditë rëndësinë që ka AZHB-a dhe a nuk ka pas kuadro të tjera për këtë pozitë ?

*Milazim Salijaj*, pyeti për rregullimin e kanalit të ujitjes në Komunën e Shtërpcës dhe nëse mundet të dërgoj dhe një regjistër kopje të pronave të Ministrisë që janë në shfrytëzim dhe të Agjencisë Pyjore të Kosovës ?

*Ministri Faton Peci*, përgjigjet për nevojën e sistemit të ujitjes dhe tha që Ministria ka vetëm 4 milion euro si buxhet vetanak, dhe se janë 8 projekte në 8 Komuna të ndryshme të Kosovës duke u implementuar, janë rajonale dhe gjithpartiake, nga 2 komuna janë të PDK, LDK, AAK dhe LVV. Konfirmon që Shtërpca është prioritet për Ministrinë, dhe një prej investimeve më të mëdha në sistemin e ujitjes do të jetë në zonën e Firajës. Pastaj Ministri mohon pretendimet e Deputetes Musliu duke e sfiduar ti përmend fermerët e “hakmarrur” nga Ministria. Ministri në fund ju përgjigjet pyetjes rreth punësimit të Venera Çerkinit, tha se duke afirmuar kredencialet e Zonjës në fjalë si një zyrtare shtetërore me 15 vjet pune dhe se ajo nuk është punësua por ka ardhur në pozite ekuivalente. *Ministri Faton Peci*, falënderoi kryetaren për korrektësi dhe mënyrën e mbajtjes së mbledhjes dhe vazhdoi dhe tha se ai viziton të gjitha fshatrat e Kosovës pa dallim dhe se mirëpritet në të gjitha vendet, po ashtu 2 milion grante janë shpërndara vetëm në rajonin e Drenicës.

*Isak Shabani*, pati kritika sa i përket përmbytjes së Raportit të punës dhe pastaj pyeti ministrin: Për kompensimet e dëmeve në vlerë 2,800.000 euro a janë të realizuar tek gjitha kërkesat apo vetëm tek ato të cilësuarat të arsyeshme? Fermerët po ashtu kanë pasur pakënaqësi për vlerësime jo reale dhe pyet specifikisht se a kanë deponuar ankesat deri tek Ministri? Pastaj përmendi se 10 milion euro duhen të barten nga Ministria tek GIZ-i Gjerman dhe se a është e vërtetë se 40% e vlerësimit të shumës do të shkojë për ekspert të fushës? Pastaj për disa shqetësime nga fermerët që merren me fara, konkretisht pyet se pse nuk ka laborator të akredituar që merret me cilësinë e farave dhe se çfarë fara importohen në Kosovë ?

*Ministri Faton Peci*, pohon se nuk ka ende laborator të akredituar dhe se janë në proces e sipër të hartimit të konceptit dokumentit për IBK-në, ai vazhdon me një rast në vitin 2019 ku është importuar një sasi e madhe e farës së misrit dhe sipas matjes bimësia ishte 95% kurse sipas laboratorëve privat ajo ishte nën 50% dhe kështu shpjegon arsyen se pse duhet akredituar një laborator zyrtar. Çështjen e GIZ-it, tha se e ka aprovuar një strategji për ofrimin shërbimeve këshillimore, dhe se në këtu hyn ajo 40% e përmendur nga deputeti Shabani. Sa i përket dëmeve tha se pas 29 shtatorit 2022 dëmet nuk kompensohen nga Ministria e Bujqësisë dhe se pavarësisht kësaj Ministria ka rikthyer disa rivlerësime në 7-8 Komuna ku pjesa kryesore ka qenë mos-raportimi i korrekt nga Komuna e Podujevës dhe Rahovecit, në fund tha se Raporti i punës është tejet korrekt dhe i përpunuar në mënyrë të mirë.

*Kryetarja Fitore Pacolli-Dalipi*, e falënderoi Ministrin.

## **6. Të ndryshme**

*Kryetarja*, njoftoi se janë duke u bërë përgatitjet për Konferencën që do të mbahet me 3 nëntor, dhe pjesëmarrjen e kanë konfirmuar disa deputetë nga disa vende. Shpenzimet e mbajtjes së konferencës i bartë FES-i, ndërsa dy deputetë të Bundestagut, kanë kërkuar nga komisioni që ti mbulohen shpenzimet.

*Për këtë komisioni vendosi që ti bëhet kërkesë Kryesisë së Kuvendit që ti mbulohen shpenzimet e për këta dy deputetë.*

*Kryetarja*, kërkoi nga kryesuesit e grupeve punuese që të ftojnë dhe ta vazhdojnë punën.

*Ganimete Musliu*, para se të vazhdohet me aktivitetet e tjera, kërkoi që në mbledhjen e radhës së pari të miratohet plani i punës për këtë sesion.

*Salih Zyba*, propozoi që në javën e ardhme të vizitohen dy agjencitë, për shkak të periudhës së tranzicionit sipas ligjit të ri të pyjeve të bëhet një vizitë në agjencinë e pyjeve.

*Kryetarja*, tha se draft planin e punës dhe për sesionin vjeshtor dhe raportin e punës për sesionin pranveror do të marrin pas mbledhjes dhe se do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti: *Stafi mbështetës i Komisionit*

***Fitore Pacolli-Dalipi,***

-----  
***Kryetare e Komisionit***